

## **AKT THEMELIMI**

### **I**

## **SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ALBA SERVICES & PARTS” sh.p.k**

Sot ne Tirane me 20.01.2021 mblidhen si me poshte:

Ortaket themelues: Eduart Dauti, atesia Sotir, lindur me date 17.02.1971 ne Kuc, Vlore Shqiperi banues ne Tirane dhe Dritan Skenderaj atesia Nazif lindur ne date 14.04.1982 ne Ninesh Fier Shqiperi, **bazuar në këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme ka vendosur krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin “ALBA SERVICES & PARTS” sh.p.k,**

### **Neni 1**

## **EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar te themeluar nga Eduart Dauti dhe Dritan Skenderaj, është “ALBA SERVICES & PARTS”sh.p.k. Kjo shoqëri e këtij lloji do të përballojë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj të paraqitur në statut nga ortaku i vetëm i saj.

### **Neni 2**

## **SELIA E SHOQËRISË**

Selia e shoqërisë është në Tirane, Kombinat në adresën: rruga “Enriko Telini”, Nr.91 Tirane. Shoqëria mund të ketë filiale,dege te saj apo edhe përfaqësi në rrethe të tjera të vendit si edhe jashtë territorit të Shqipërisë. Hapja e degëve ose filialeve ne qytete të tjera do te bëhet me aplikimin ne Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit te Bashkise ku shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, ose ne seline qendore te QKR ne Tirane.Miratimi do të bëhet nëpërmjet pajisjes se shoqërisë me çertifikatën e regjistrimit perktes te deges apo filialit. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim te Ortakut te Vetem. Për këtë ndryshim do të vihen në dijeni organet shtetërore përkatëse, për të bërë ndryshimet e duhura.

### **Neni 3**

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

**Shoqeria ka per objekt te veprimtarise :** Import, Export , Tregtim automjetesh te cdo lloji,marke e tonazhi,si dhe pjesesh kembimi per to. Tregtim karburantesh te ndryshme,vajrash lubrifikante,te cdo tipi e lloji,me shumice dhe pakice.Transportimin e mallrave brenda dhe jashte vendit,trajnim te brendshem ose te jashtem te stafit dhe edukim profesional, aktivitete te lidhura ose te ngjashme me marketingun dhe cdo aktivitet tjetër i konsideruar i nevojshem dhe i vlefshem, per realizimin e qellimit te shoqerise.

Shoqeria mund ti kryej aktivitetet e mesiperme per llogari te vet ose te personave te trete.

Si objekt te veprimtarise se saj shoqeria do te kete edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik te lejuar nga legjislacioni shqiptar, qe perputhet me objektin e veprimtarise se saj te cilat kane rendesi per te ardhmen e shoqerise.

### **Neni 4**

## **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria mund ta ushtroj veprimtarine e saj per nje afat 10 vjet me te drejte zgjatje afati. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë e saj përpara këtij afati në rastet e prishjes ose likuidimit të shoqërisë



të parashikuara këto në Ligjin Nr 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, por vetëm pasi për këtë të ketë vendosur Asambleja e Ortakeve.

*Neni 5*

**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali Themeltar i shoqërise “ALBA SERVICES & PARTS” sh.p.k, është **100 000 (nje qind mije) leke**, kapital ky i zotëruar nga ortakët Eduart Dauti dhe Dritan Skenderaj, i cili është i depozituar në një Bankë në Republikën e Shqipërisë.

Kapitali është i ndarë në kuota me nga 100.000 leke secila dhe është i vlerësueshem me 2 kuota nga 50% gjithsej, që përbejnë 100% të kuotave të kapitalit të shoqërise “ALBA SERVICES & PARTS” sh.p.k,

*Neni 6*

**TRANSFERIMI I KUOTAVE APO NDRYSHIMI KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie midis trashëgimtarëve ligjorë të ortakut themelues. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rastet ndarje pasurore mes bashkëshortëve, si dhe ndërmjet pasardhësve e paraardhësve të tij

Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar të ortakut të vetëm themelues do të bëhet me Vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë për veprime të shitjes apo transferime kapitali në formë të tjera sipas ligjit. Ortaku themelues i shoqërise me vendim të tij mund të shtojë apo pakesoje kapitalin themeltar në çdo periudhë që e shih të nevojshme, në përputhje me dispozitat ligjore. Gjithashtu po me Vendim të ortakut të vetëm mund të shtohet, pakësohet ose ndryshohet objekti i veprimtarisë së shoqërisë, sipas formës dhe objektivit të parashikuar nga ligji shqiptar, pas miratimit nga organet shtetërore kompetente, nëse kjo kërkohet nga ligji.

*Neni 7*

**ORGANI VENDIMARRËS**

Organi më i lartë në marrjen e vendimeve të shoqërise është Asambleja e Ortakeve. Ajo vendos për emerimin, shkarkimin apo ndryshimin e administratorit (person tjetër jopronar), si dhe marrja e çdo vendimi tjetër që është në përputhje me ligjin. Në rastin kur Asambleja vendos të shtojë ortakë të tjerë në shoqëri, organi drejtues vendimarrës i shoqërise është perseri Asambleja e shoqërise.

*Neni 8*

**VULA DHE STEMJA**


**Shoqëria ka vulën dhe stemën e saj, në të cilën është shkruar:** Republika e Shqipërisë, Shoqëria “ALBA SERVICES & PARTS” sh.p.k, Vula ka formë rrethore dhe administrohet dhe disponohet nga Administratori dhe ortakut i vetëm i shoqërisë.

Shoqëria ka stemën e saj të veçantë të dallueshme nga shoqëritë e tjera. Të gjitha shkresat që formulohen dhe dalin nga shoqëria duhet të nënshkruhen nga administratori dhe të vulosen me vulën e shoqërisë.

*Neni 9*

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akti Themelimi edhe me normat e përcaktuara në Statutin e saj, të cilin do ta nënshkruajnë ortakët themelues e më pas do të bëhet regjistrimi në Qendren Kombëtare të Regjistrimit Tirane, ditë në të cilën do të bëhet edhe legalizimi si person juridik në Shqipëri i kësaj shoqërie.




Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky Akt Themelimi dhe Statuti përkatës do të vlejnë dispozitat e Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, seksioni për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si dhe aktet e tjera ligjore apo nenligjore në fuqi.

***Neni 10***


Ky akt themelimi është hartuar në 2 kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila kopje fuqi të njëjtë ligjore. Nga këto, një kopje depozitohet në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Kopjet e tjera do të qëndrojnë në selinë e shoqërisë si dokument themelor i krijimit të shoqërisë “ALBA SERVICES & PARTS” sh.p.k,

***ORTAKET***

***EDUART DAUTI***

Handwritten signature of Eduart Dauti in black ink, consisting of a stylized cursive script.

***DRITAN SKENDERAJ***

Handwritten signature of Dritan Skenderaj in black ink, consisting of a stylized cursive script with the name written below it.